

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQATA “MARATON ALBANIA”**

Tiranë më ____ . ____ . 2022

Projekt Kulturor, Rinor, Sportiv me qëllimin e edukimit të masës së qytetarëve Shqiptar dhe të huaj, të gjithë grup moshave dhe stimulimin e kuptimit më drejt të vlerave të atletikës e në veçanti të maratonës si sporte ndër më të hershmit e më të efektshmit në formimin fizik të njeriut

**Half Maratona dhe maratona 10 km e nates ” Enkelana”
(Maratona nate në Qytetin e Pogradecit)**

30 Korrik 2022

1. Hyrja,

Të vrapojmë së bashku me turizmin buzë liqenit të Pogradecit, historinë dhe bukurive të natyrës së Qytetit të Pogradecit ...

1.1. Vështrim i përgjithshëm

Half maratona e nates do të zhvillohet në rrugën e re, shetitoren e Pogradecit, rruga kalon buze liqenit të bukur të Pogradecit, me start fshati karakteristik dhe i vjeter “Lin” deri në qytetin e Pogradecit. (Finish percaktohet me matje të sakte 21 Km 97 ml.)

Pjesëmarrësit do të jenë nga të gjitha të gjitha trevat Shqiptare por edhe nga vendet e tjera të Botes të cilët kanë dëshirë të shijojnë turizmin e bukur që afrohet qyteti I Pogradecit dhe fshatrat përreth tij.

Half maratona e natës në qytetin e Pogradecit, “Enkelana”, Do të jetë një sfidë e re mahnitëse, për të gjithë pjesëmarrësit, vizitorët e shumtë që ndodhen në qytetin e Pogradecit në muajin e nxehtë të Korrik-ut, do të garohet në rrugën buzë liqenit, asfalt

i sheshtë, shëtitore, një rrugë që kalon mes freskisë që afron liqeni mahnitës i Pogradecit, aromës së luleve, pikave të shumta të furnizimit me ujë e lëngje frutash. Nën ritmikën e hapave të vrapuesve, do të sinkronizohen të ringjallura pulsacionet e këtij aktiviteti ballkanik me ridimensionime të jashtëzakonshme nga historia më e moçme e qytetit të Pogradecit.

1.2 Si lindi Ideja?

Anëtarët e shoqatës “Maraton Albania”, në mënyrë kronike ushtrohen në zonat të ndryshme të vëndit, dhe përherë ëndrra e tyre ka qenë ta përshkojnë rrugët e bukura të vëndit tonë; në këtë kënd vështrimi edhe rruga buzë liqenit të bukur të Pogradecit është vëndi pushimit dhe stërvitje njëkohësisht, muaji Korrik, për sportistët nga e gjithë Shqipëria dhe pse jo nga trojet Shqipfolëse të Shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, sikurse qyteti Ohrit, Kumanova, Shkupi, Gostivari, Tetova, Dibra e Madhe etj.

1.3 Çpërfaqëson organizatori, zhvilluesi i këtij projekti, “Maraton Albania”,

Me Aktin e Themelimit Nr. 532, Datë 30.04.2019, Nr. Vendimi 6255 Datë 24.05.2019, prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë – Albania, është kryer regjistrimi si person juridik i Shoqatës “MARATON ALBANIA”, në bazë të Ligjit nr.8788, datë 07.05.2001 ‘për organizatat jo fitimprurëse’, si dhe të Ligjit nr. 8789, datë 07.05.2001 ‘Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse’. Objekti i shoqatës janë, bashkimi vullnetar i njërëzve të thjeshtë, sportistë, persona fizikë, juridikë, intelektualë, specialistë të fushave të ndryshme të ushtrimit të vrapimit me ecje, ecje sportive, vrapim aerobik, gjysëm maratonë, maratonë e plotë, ultra maratonë, trialton, vrapim shpejtësie, i garave sportive, evidentimin e vlerave sportive në të gjithë rrethet e Shqipërisë. Ndërgjegjësimi dhe përfshirja e të gjithë kategorive të ndryshme të njërëzve për t’u ushtruar sistematikisht në mënyrë të ndërgjegjshme me ecje, në kushte të ndryshme me nivele vështirësie, me vrapim aerobik, si një ndër veprimtaritë fizike me efektshmëri të lartë e të gjithanshme jetësore, me vlera zhvilluese, profilaktike, dhe kurimi shëndetësor me qëllim të përmirësimit për një jetë sa më aktive dhe rendiment më të lartë mendor, fizik shëndetësor, profesional.

Shoqata “Maraton Albania” ka mendur që ky projekt të ideojë, të krijojë, të drejtojë, të ndërgjegjësojë e të aktivizojë në këtë lëvizje sportive masive një numër sa më të madh njerëzish, pavarësisht nga mosha, gjinia, shkalla e zhvillimit fizik, mendor, sportiv dhe shëndetësor. Shoqata ka punuar sistematikisht të ideojë, të informojë nëpërmjet mediave, të sqarojë dhe inkurajojë njerëzit për një domosdoshmëri në ndryshimin e mënyrës së jetesës, për një jetë sa më aktive e me rendiment të lartë, për një ekuilibër të plotë psikologjik, fiziologjik dhe shëndetësor.

Kryesia e shoqatës ka organizuar njoftime periodike për stërvitje nëpërmjet veprimtarive, ka zhvilluar programe, promovime, biseda dhe konsulta me të gjithë të interesuarit për dobinë e veprimtarisë fizike. Për të zhvilluar maratona, për të krijuar kushte sa më optimale stërvitore për ushtrimin amator sikurse në mjediset e parkut të Liqenit Artificial të Tiranës, Parkun kombëtar të “Dajtit” dhe të organizojë maratona të përvitshme për qytetin e Tiranës dhe në rrethet e tjera të vendit, bazuar në standartet kombëtare dhe ndërkombëtare të Atletikës

1.4. Pjesëmarrja në Aktivitete të maratonave brënda dhe jashtë shtetit të anëtarëve të shoqatës “Maraton Albania” eksperiencia. dhe përvoja e fituar.

Anëtarët e shoqatës “Maraton Albania” kanë marrë pjesë me sukses në shumë maratona të zhvilluara në Tiranë dhe në qytete të tjera, kombëtare dhe ndërkombëtare, duke treguar një profesionalizëm dhe teknikë të lartë tekniko-organizative. Anëtarët e shoqatës kanë zhvilluar dhjetra maratona kombëtare dhe ndërkombëtare.

1 Objekti i Projektit

Realizimi i Half maratonës së natës në qytetin e Pogradecit, 21 km e 97 ml. nga sportistët e shoqatës “Maraton Albania” si një sfidë sportive dhe jo vetëm. Realizimi i kësaj maratone do të tregojë që maratonistët Shqipëtarë janë të aftë të ndërmarin sfida të një përmase dhe kalibri botëror duke konkuruar me kolegët e tyre të rajonit dhe duke hapur një faqe të re në historinë e maratonave kombëtare dhe eksperimentimin e maratonave me gjatësi mbi ato klasiket.

2 Qëllimi i Projektit

3.1. Rritja e kapaciteteve të turizmit atraktive në qytetin e Pogradecit.

Nëpërmjet organizimit dhe zhvillimit të Half maratonës ndërkombëtare “Enkelana” si një maratonë e dimensioneve kombëtare dhe ndërkombëtare do të rrisë kapacitetet e turizmit në qytetin e bukur të Pogradecit, dhe ta kthejë këtë qytet, në një qytet funksional sportive - turistike, të aksesueshëm nga grupe vrapuesish dhe atletësh sportivë, grupe interesi, grupe turistike etj,

3.2. Promovimi i qytetit të Pogradecit dhe fshatrave me tradita turistike,

Duke u njohur me qendrat e banuara por edhe me vëndet që e ruajnë të freskët identitetin historik, do të përshkohet një itinerar mjaft interesant: nga qendra e fshatit piktoresk buze liqenit “Lin” drejt qytetit të Pogradecit ku rruga kalon duke lënë djathtas bukurinë e fshatrave Piskupat, Hudënisht, Memlisht, Kështu, shoqata “Maratona Albania”, do e përgatit eventin sipas të gjitha nevojave, për t’i siguruar pjesëmarrësve akomodimin, ndalesat e pushimet aktive, furnizimi me ujë, por edhe promovimin e një stili nxitës të shpirtit të garës. duke bërë të mundur që Shqiptarët por edhe të huajt të shijojnë më shumë këtë rrugë, bukuritë natyrore të pazëvendësueshme të cilat i gjen vetëm në qytetin dhe fshatrat e Pogradecit.

3.3. Bukuritë e natyrës për gjatë vijimit të Half maratonës së natës “Enkelana”,

Në fokus do të vihet fragmenti nga qendra e fshatit Lin - Pogradec, ky fragment do të jetë i mirë treguar përmes fletë tregueseve ku do të zhvillohet half maratona e natës, (kjo fletë format A4, i ipet çdo pjesëmarrësi në çantën individuale ku përmban përshkrimi i detajeve teknike treguese) për pasurinë në rrafshin kulturor-historik, duke bashkuar lidhjet e trevave tona Shqipfolëse dhe ato Ballkanike, por edhe lidhjet ndërkontinentale mes shteteve të Evropës.

3.4. Vëndet historike që vizitohen gjatë ditëve të qëndrimit, udhëzohen shoqëruesit.

Kjo nismë nuk është vetëm sfidë sportive, por do tu japi mundësi pjesëmarrësve që të njohin vlerat turistike dhe historike që ka patur ky qytet. Pikërisht kjo ka qenë edhe arsyeja përse shoqata e përzgjedhi këtë maratonë. Nëpërmjet këtij rrugëtimi do të bashkohen në një drejtim turizmi dhe sporti, kultura dhe shëndeti, në mënyrë që të zgjohen emocionet në ditët e nxehta të Korrikut, por edhe të një shëndeti mendor dhe fizik të kohës së sotme. Por çfarë përmban turizmi në qytet. (të pershkruehen vëndet në fletët shpjeguese që shoqërojnë materialet e maratonës në çanta)

- A. Fshati Tushemisht e Drilon, bukuria që afron, ujjat tokësore dhe nëntokësore, peshku i veçantë i Koran - it që afron liqeni, kulinaria etj. – (pak histori për shtëpinë dhe vëndin ku është xhiruar, filmi zonja nga qyteti dhe aktoren e madhe të teta Olgës ...etj.)
- B. Hoteleria për rreth Liqenit -
- C. Muzeu i qytetit -
- D. Fshatrat me cilësi turistike....

3 Programimi, tre fazat e projektit, faza e parë para përgatitore, faza e dytë përgatitore dhe faza e tretë zbatimi.

4.1. Programi i fazës parapërgatitore të projektit half maratona dhe maratonës 10 km të natës “Enkelana”.

Nr.	Përshkrimi i veprimtarive	Realizimi					Janë përfshirë	
		Mars	Prill	Maj	Qer.	Kor.		
1	Sigurimi i Hartave topografike 1:25000.						PO	D.Çali, L.Peço
2	Evidentimi i rrugës, matja e sakte, shënjestrimi krijimi i hartës treguese me detaje të zhvillimit të half maratonës.						PO	D.Çali, L.Peço,s. Qiriaqi
3	Kontaktimi i kompanisë për kohë matësin.						PO	D.Çali, L.Peço,B.Danaj
4	Kontaktimi i vullnetarëve, Moderatorit të aktivitetit të jetë njohës i mirë i gjyhës Angleze dhe njohës i mire i zhvillimit të maratonave , sportit, dhe i qytetit të Pogradecit.						PO	D.Çali, L.Peço, S.Godella, N.Kurteshi, A.Bregu, E.Rexhepi, Sh.Vulaj, G.Veisi,
5	Intervista, njoftimi i banorëve të rrugë kalimit, njoftimi komunitetit vëndas dhe komunave.						PO	D.Çali, L.Peço, S. Qiriaqi
6	Rikonicioni, eksplorimi në teren, me përgjegjësit e vullnetarëve..						PO	D.Çali, L.Peço, S.Godella, N.Kurteshi, A.Bregu, E.Rexhepi, Sh.Vulaj, G.Veisi,
7	Shënjimi i rrugës, në mënyrë profesionale për t'u shfrytëzuar nga vrapuesit, turistët etj.						PO	D.Çali, L.Peço, R.Bahidi, S.Godella, N.Kurteshi
8	Përgatitja e efektivit të Shoqatës “Maraton Albania” për ta realizuar këtë half maratonë nate.						PO	D.Çali, L.Peço,A.Bregu
9	Koordinimi i përgatitjes individuale me atë kolektive dhe përthithja e sa më shumë atletëve në këtë nismë.						PO	D.Çali, L.Peço,A.Bregu
10	Të përgaditet spoti i njoftimit për TV lokale dhe shtetërore për zhvillimin e maratonës.						PO	D.Çali, L.Peço, S.Godella, N.Kurteshi, A.Bregu, E.Rexhepi, Sh.Vulaj, G.Veisi,
11	Të bëhen përpjekje për ta regjistruar tek kalendari i maratonave Europiane.						PO	D.Çali, L.Peço,A.Bregu
12	Promovimi i anëtarëve me eksperiencë dhe sidomos vajzave që janë në numër të vogël.						PO	D.Çali, L.Peço, S.Godella, N.Kurteshi, A.Bregu, E.Rexhepi, Sh.Vulaj, G.Veisi,
13	Filmime dhe publikime në web site, facebook, histogram, twiter, nga fazat përgatitore, përgaditja, kapacitetet, kualiteti dhe zhvillimi, për publikim në media,						PO	D.Çali, L.Peço, S.Godella, N.Kurteshi, A.Bregu, E.Rexhepi, Sh.Vulaj, G.Veisi,

8	Njoftimi autoriteteve vendore Bashki, Komuna dhe pjesëmarja e tyre në këtë aktivitet, fjala e hapjes, të ftuar, përgaditja e fjalës së rastit për të gjithë folësit, programi.						D.Çali, A. Bregu, A.Bruci, S. Godella, G. Veis, N. Kurteshi, E. Qirici, A. Xira, L. Vogli, Sh. Vulaj
9	Njoftimi i moderatorit të maratonës, vullnetarëve.						D.Çali, A. Bregu, A.Bruci, S. Godella, G. Veis, N. Kurteshi, E. Qirici, A. Xira, L. Vogli, Sh. Vulaj
10	Shoqërimi i kompanisë matëse të kohës dhe marja e masave për mbarëvajtjen e kohë matjes.						D.Çali, A. Bregu, A.Bruci, S. Godella, G. Veis, N. Kurteshi, E. Qirici, A. Xira, L. Vogli, Sh. Vulaj
11	Njoftimi dhe prezenca e personelit shëndetësor në zhvillimin e half maratonës së natës.						D.Çali, A. Bregu, A.Bruci, S. Godella, G. Veis, N. Kurteshi, E. Qirici, A. Xira, L. Vogli, Sh. Vulaj
12	Njoftimi dhe prezenca e forcave të sigurisë, policisë shtetit për sigurinë dhe mbarëvajtjen në zhvillimin e half maratonës së natës.						D.Çali, A. Bregu, A.Bruci, S. Godella, G. Veis, N. Kurteshi, E. Qirici, A. Xira, L. Vogli, Sh. Vulaj
13	Jepen variante për akomodimin e pjesëmarësve, natën e parë datë 29.07.2022, hotele, ambiente sportive, teritore kampingu për vendosjen e çadrave, automjeteve etj. .					JO	D.Çali, A. Bregu, A.Bruci, S. Godella, G. Veis, N. Kurteshi, E. Qirici, A. Xira, L. Vogli, Sh. Vulaj
14	Altiviteti fillon ditën e shtunë me datën 30.07.2022, në orën 17.00 me nisjen me autobus, drejt pikës së nisjes fshatit Lin.					JO	D.Çali, A. Bregu, A.Bruci, S. Godella, G. Veis, N. Kurteshi, E. Qirici, A. Xira, L. Vogli, Sh. Vulaj
15	Furnizimi, me ujë, fruta ,përkujdesi shëndetësor, tualetet, etj. para fillimit të maratonës dhe pushimet e rradhës.					PO	D.Çali, A. Bregu, A.Bruci, S. Godella, G. Veis, N. Kurteshi, E. Qirici, A. Xira, L. Vogli, Sh. Vulaj
16	Pas përfundimit të maratonës, furnizimi, me ujë, ushqime , përkujdesi shëndetësor, tualetet, etj.					PO	D.Çali, A. Bregu, A.Bruci, S. Godella, G. Veis, N. Kurteshi, E. Qirici, A. Xira, L. Vogli, Sh. Vulaj
17	Filmime dhe publikime në web site, facebook, histogram, twitter, nga faza përgatitore për publikim në media....,					JO	D.Çali, A.Bruci, G. Veis, E. Qirici, A. Xira,
18	Administrimi shpërndarja e materialeve promovimi, dekori, fletë-palosje, flamuj, stenda, banderola etj. Që do të përdoren në finish të maratonës.					JO	D.Çali, A. Bregu, A.Bruci, S. Godella, G. Veis, N. Kurteshi, E. Qirici, A. Xira, L. Vogli, Sh. Vulaj
19	Marja e masave për sigurimin e fondit të shpërblimeve për fituesit e half maratonës natës dhe minimaratonës.						D.Çali, L.Peço, A. Sukniqi
20	Cerominia e shpërndarjes së Stimujve , datë 30.07.2022 ora 21:00 – 22:00, të ftuar, programi.					JO	D.Çali, A. Xira, Sh. Vulaj
21	Media, foto para dhe gjatë aktivitetit dhe pas, intervista televizive....,					JO	D.Çali, A. Bregu, A.Bruci, S. Godella, G. Veis, N. Kurteshi, E. Qirici, A. Xira, L. Vogli, Sh. Vulaj
22	Shpërndarja e madeljave pjesëmarësve , cerominia e finishit, shpërndarja on-line e çertifikatave pjesëmarëse dhe rezultatet në web – site e maratonës.					JO	D.Çali, A.Bruci, E. Qirici, A. Xira, Sh. Vulaj
23	Fjala e rastit në ceromoninë e finishit, komuna e fshatit Lin, përgaditja e fjalës se hapjes.					JO	D.Çali, A.Bruci, E. Qirici, A. Xira, Sh. Vulaj

24	Festë pas maratone, koktejl për pjesëmarrësit në aktivitet.					JO	D.Çali, A. Bregu, A.Bruci, S. Godella, G. Veis, N. Kurteshi, E. Qirici, A. Xira, L. Vogli, Sh. Vulaj
25	Vend akomodimi i pjesemaresve, Dita e fundit date 31.07.2020 , njohja me ambientet shplohese e akomodimi kushtet, fjetje, Darka, Mengjesi ne ora 10:00 , aktivite permyllese.					JO	D.Çali, A. Bregu, A.Bruci, S. Godella, G. Veis, N. Kurteshi, E. Qirici, A. Xira, L. Vogli, Sh. Vulaj

5. Cili janë problemet kryesore që duhet të zgjidhen;

5.1 Me Bashkinë e Qytetit Pogradec, Me Sektorin e Kulturës, Rinisë , Sporteve, dhe Promovimit të Turizmit në Rajon;

1. Përfshirja e Bashkisë Qytetit Pogradec, njoftimi dhe pjesëmarrja aktive e saj, sidomos të Departamentit të kulturës rinisë, sporteve, dhe promovimit të turizmit, për njohjen me projektin dhe hapat që do të ndërmeren;

- a. Aplikimi për mbështetje me fonde financiare..., pranë Departamentit të Kulturës, Rinisë dhe sporteve, detyrë të cilën do e ndjekin përfaqësuesi Z. Arjan Sukniqi, Kryetari z. Dashmir Çali dhe Sekretari z. Leonard Peço.
- b. Kërkesa për të anëtarësuar në shoqatën tonë si anëtarë me të drejta të plota Bashkinë e Qytetit Pogradec.

5.2 Kërkesa për sponsor për sigurimin e buxheteve të mjaftueshme financiare apo bazë materiale;

- a. Gjetja e sponsorave për qasjen si të atyre që na kanë mbështetur deri më tani në projekte të ndryshme por edhe duke i adresuar edhe në dashamirës të tjerë dhe konkretisht do të kryen takime dhe biseda me kompaninë “Arktik” me administrator z. Shyqyri Dade, kompaninë “Agna” group me administrator z. Kristo Naçi, me kompaninë “Dashi Alumin” etj.

5.3 Sigurimi i buxheteve të mjaftueshme financiare, bazë material, akomodimi;

- a. Nga llogaritjet e bëra deri më tani për realizimin e këtij projekti për 500 pjesëmarrës (200 pjesëmarrës në half maratonë 21 Km dhe 300 pjesëmarrës në 10 Km) na duhen 10.000 Euro duke e çveshur këtë kosto nga disa premtime të dhëna nga sponsorat tanë për transport, ujë, lëngje, ushqime etj. Dhe nga disa pagesa të cilat edhe presin.

- b. Për akomodimin e pjesëmarësve mund të shfrytëzohen edhe kampingje buzë liqenit të Pogradecit me çadra për një dhe dy persona, këto u ipen pjesëmarësve me kosto të ulët sepse është sezoni i verës që mundëson përdorimin lehtësisht të tyre. Kampingjet domosdo duhet të kenë të siguruar vënd parkimi automjeteve, shërbim interneti, tualete, furnizim me ujë mundësisht vënd gatimi etj.



5.4 Kosto e regjistrimit për anëtarët e pjesëmarësit për aktivitetin dhe Tarifa (FI) e pagesës për regjistrim në garë, regjistrimi për të dy grupet që kanë dëshirë të regjistrohen në half maratonën e natës dhe në minimaratonën.

5.5 Tarifa e regjistrimit për half maratonën e natës (me kosto)

- a. Paketë e plotë ku përfshihet aktiviteti, akomodimi, transporti, 70 Euro
- b. Pketa ku përfshihet vetëm pjesëmarje në aktivitet, 2500 leke ose 20 Euro

5.6 Tarifa e regjistrimit për minimaratonën (kosto + shpenzime shoqate)

- a. Paketë e plotë ku përfshihet aktiviteti, akomodimi, transporti, 70 Euro
- b. Paketa ku përfshihet vetëm pjesëmarje në aktivitet, 10 Euro

6. Analiza e risqeve, për mos realizimin e disa hapave, projektit mund të rrezikohen të mos plotësohet, do me thënë të dështojë..

6.1. Buxheti, fondi financiar minimal për kryejën e aktivitetit.

Për realizimin e këtij projekti nga ana organizatorëve duhen 7.000 Euro për prodhimin e bluzave, çantave, madeljeve, dekori dhe Chip për matjen e kohës.

Shpenzimet e tjera, transport, fjetje, ushqim, akomodim etj. Do të paguhen nga pjesëmarrësit.

6.2. Shpërblimi, dhuratat, çertifikata për fituesit e vëndeve të para , të rinj dhe të moshuar, sipas grup moshave etj.

Në mënyrë që të ketë një maratonë sa më cilësore për nga rezultatet, të ketë një pjesëmarrje sa më të madhe në numër dhe në mënyrë që pjesëmarrësit tëndjehen të vlerësuar e të respektuar për këtë organizim, një rol të rëndësishëm luan edhe shpërndarja e shpërblimeve, dhuratave dhe çertifikatave promovuese.

Shpërblimet dhe dhuratat, llogariten e jepen në bazë të mundësive që ka organizatori dhe sponsorat, shtrirja e tyre në një bazë sa më të gjërë i jep seriozitet dhe rrit pjesëmarrjen dhe motivon vrapuesit.

- ✓ Shpërblim, dhurata për fitues meshkuj, femra vëndet e para.
- ✓ Shpërblim, dhurata për fitues meshkuj, femra vëndet e para për grup moshë.
- ✓ Shpërblim, dhurata për të rinj dhe të moshuar, pjesëmarrës në maratonë.
- ✓ Prioritet kanë vrapuesit vëndas femra dhe djem.

6.3. Regjistrimi, publikimi, njoftimet në media, roli i medias etj.

Në mënyrë që të ketë një pjesëmarrje sa më të madhe në numër nga qytetet e tjera të Shqipërisë, vëndet fqinje dhe të Europës e rëndësishme është që të realizohen disa detyra të rëndësishme sikurse;

1. Regjistrimi dhe njoftimi në Word Marathon ndërkombëtare duke e vendosur atë në kalendarin ndërkombëtar të maratonave, për këtë duhet që të plotësohen formularët e garancisë së zhvillimit të maratonës, formularët teknikë, juridikë, shëndetësor, shpërblimeve, akomodimeve, sigurisë etj. Në bazë të standarteve dhe kushteve të maratonave ndërkombëtare.
2. Publikimi në rrjetin e internetit web site me emrin e maratonës, facebook, twitter, histogram, etj. Të gjithë materialeve tekniko organizative të zhvillimit të maratonës, mënyrën e regjistrimit, pagesës së regjistrimit, njoftimin periodik etj.
3. Publikimi dhe përgaditja e spoteve televizive, radio, këto me shtrirje me sinjal local dhe kombëtar, emisioneve dhe njoftimeve disa muaj përpara për zhvillimin e maratonës së natës në qytetin e Pogradecit.

Përlllogaritja e shpenzimeve të domosdoshme për realizimin e aktivitetit,

Nr.	Emërtimi i zërave të domosdoshëm për realizimin e aktivitetit	Numuri i parashikuar i pjesëmarrësve	Çmimi Euro	Kosto Euro	Kur duhet të jenë Gati	Shënime

1	Bluza me logon e aktivitetit.	500	3	1500	Para Aktivitetit	
2	Numuri gares me chip, bashkë me infrastrukturën matëse të kohës (Antenat dhe ora tabela elektronike) .	500	3	1500	Para Aktivitetit	Tabela me logon e Aktivitetit, organizatorëve dhe sponsorave.
3	Qese plastike me logon e aktivitetit.	500	0.4	200	Para Aktivitetit	Logot e organizatorëve, Nr. Tel kontakti, Email, web-site, të organizatorëve etj.
4	Fletë treguese e garës dhe informacione për aktivitetin, shoqëron qesen e bluzës me numurin e garës.	800	0.3	240	Para Aktivitetit	Gjithashtu këtu vendosen edhe rekomandime restorante , hotele, supermarkete , dyqane me interes të qytetit dhe rrethit, vëndase etj.
5	Transportimi vrapuesve nga Pogradeci në fshatin Lin,	200	0.8	160	Para Aktivitetit	Vëndi i Nisjes orari etj.
6	Shërbime ndimëse, (pagesa e vullnetarëve).	10	100	1000	Pas Aktivitetit	10, anëtarë të shoqatës bashkë me nga një shoqërues (mundësisht mosha 18 – 22 vjeç) do të meren me shënjestrimin e rrugës, shoqërimin e vrapuesve udhëtimi, bojë , shiritat tregues, hotel, ushqim, organizimin dhe funksionimin e pikave të furnizimit me ujë, lëngje e produkte ushqimore etj.
7	Pagesa Lokale të parashikuara.	5	100	500	Para Aktivitetit	Mbështetës për mbarrëvajtjen e projektit Elektriku, Spitali, Bashkia, Komuna etj.
8	Flete palosje, shtypshkrime.	800	0.32	256	Para Aktivitetit	Informacione për Maratonën, organizatorët, sponsorat, qytetin, turizmin etj.
9	Dekori në fshatin Lin , Starti dhe në qytetin e Pogradecit.	2	250	500	Para Aktivitetit	Kolonat mbajtëse (kjo influencon edhe në koston e infrastrukturës matëse me chip, vendosja e tabelës elektronike, orës etj.)
10	Medalje, Në përfundim të aktivitetit pjesëmarrësve do t'u ipet medalje.	500	5	2500	Para Aktivitetit	Medalje e personifikuar me logon e aktivitetit.
11	Shpërblime për fituesit.			1400	Para Aktivitetit	Fituesit e tre vendeve të para meshkuj, femra, grup moshë etj.
12	Të ndryshme.	1	250	250	Pas Aktivitetit	
SHUMA NE LEKE				10006		

7. Noterizimi i Projektit, e drejta e autorësisë.

Në mënyrë që të bëhet një punë serioze dhe e qëndrueshme për shoqatën “Maraton Albania” projekti të noterizohet me të drejtën e autorësisë duke përfshirë tre aktorë në % që bihet dakort përpara noterit;

- Shoqata “Maraton Albania” me të drejtat e organizatorit dhe të shumicës.
- Sponsorat apo financuesit të aktivitetit me të gjitha detajet për mbarrëvajtjen e tij.
- Një autoritet Shtetëror Bashkia Qytetit Pogradec, Ministria e Kulturës, Turizmit dhe Sporteve.


8. Intenerari, eksplorimi i rrugës ku zhvillohet half maratona e natës “Enkelana”.

Rruga është terësisht e asfaltuar, shëtitorja nga fshati Lin drejt Pogradecit, do të vrapohet në pjesën e djathtë të rrugës në drejtimin Lin – Pogradec, fillimisht rruga kalon daljen nga fshati Lin, pastaj vrapuesit do të vrapojnë në korsinë e shëtitores, kujdes duhet të tregohet nga forcat e sigurisë në rrugë, policia e Shtetit, autoritetet e


qarkullimit rrugor që në orarin që zhvillohet maratona nga ora 19:00 – 22:00, automjetet do të lëvizin me kujdes në krahun e majtë të saj, (nje krahe i rrugës mundësisht duhet i lirë) dhe në disa pika sikurse kryqëzimet të ndërpritet qarkullimi ose të bëhet kelim i kujdesshëm.

Nga vrapuesit do të shijohet ajri i freskët i liqenit, duke admiruar peisazhet e një natyre që flet me gjuhën e mrekullisë. Duke u njohur me qëndrat e banuara por edhe me vëndet që e ruajnë të freskët identitetin historik, do të përshkohet një itinerar mjaft interesant:

**Gjatësia e rrugës asfalt “Enkelana”, 21 Km. e 97 ml
Nisja , Starti qënra e fshatit Lin.
Mbërritja, Finish në qëndër të qytetit të Pogradecit.**








9. Tabela e segmenteve të rrugë kalimit, distancat, kategoria e rrugës dhe kohëzgjatja.

Nr.	Segmentimi Rrugës dhe shërbimet	Distanca Km Rruge Asfat	Kategoria Vështirësisë	Stacion Furnizimi
I	Half Maratona e nates 21 Km 97 ml	21.97 KM	Asfalt	3
1	Fshati Lin – Fshati Piskupat	4.8		Uje I fresket
2	Fshati Piskupat - Kompleksi Hotel Lyhnidas	4.7		Uje, lengje frutash

Tel Mob.(++355)(0)694137550 ++355(0)/696066085 | Rr. Vllazën Huta Nr. 101/1, Tirana – Albania,
 Web page; www.maratonalbania.al Email dashamir_cali@hotmail.com


3	Kompleksi Hotel Lyhnidas - Fshati Hudenisht	4.1		Uje, fruta
4	Fshati Hudenisht – Fshati Memëlisht	3.3		Uje
5	Fshati Hudenisht – qyteti Pogradec	4.1		Uje, lengje, fruta
	SHUMA	21.1		10

9.1 Starti Fshati Lin – Fshati Piskupat, Gjithësej 4.8 Km. (pikë furnizimi me ujë)






9.2 Fshati Piskupat – Kompleksi Hotel Lyhnidas , 4.7 Km (pike furnizimi me uje)






9.3 Kompleksi hotel Lyhnidas - Fshati Hudënisht, 4.1 Km , (pikë furnizimi me ujë & banane ose mollë, shalqi, qershia)






9.4 Fshati Hudënisht – Fshati Memlisht , 3.3 Km , (pikë furnizimi ujë, mollë, shalqi)





9.5 Fshati Memëlisht - Qyteti Pogradecit , (Finish Pikë furnizimi ujë, fruta)







10. Itenerari, eksplorimi i rrugës ku zhvillohet maratona 10 Km e natës “Enkelana”, kohë zgjatja e saj 2 orë.

Rruga është tërësisht e asfaltuar, do vrapohet brënda në qytet, shëtitorja nga qendra e qytetit drejt pjesës veriore, kthesa në hyrje të qytetit përshkruhet unaza, rreth rrutullimi , kthehemi majtas drejt rrugës nacionale, vrapohet pa ndaluar deri në qendër të fshatit Drilon dhe kthimi drejt shëtitores.

Do të vrapohet në formë unaze, në gjithë gjërësinë rrugës në drejtim të fshatit Drilon, (segmenti unaza e qytetit dhe rruga nacionale bllokohet vetëm 30 minuta), dhe pastaj vrapuesit do të vrapojnë në korsinë e shëtitores, kujdes duhet të tregohet nga policia e Shtetit autoritetet e qarkullimit rrugor që në orarin që zhvillohet maratona nga ora 19:00 – 21:00, automjetet do të lëvizin me kujdes në krahun e majtë të saj , mundësisht në disa pika sikurse kryqëzimet, të ndërpritet qarkullimi nga pjesa e unazës dhe rruga nacionale (gjatësia 2 km maksimumi 30 min në kohën që starton maratona ky segment është në kilometrin e 2 – 3 të vrapimit) ose të bëhet kelim i kujdesshëm.

Nga vrapuesit do të shijohen rrugët e pastra të qytetit, lulet e shumta të stinës, ajri i freskët i liqenit të Pogradecit, duke admiruar peisazhet e një natyre që flet me gjuhën e mrekullisë. Duke u njohur me qendrat e banuara por edhe me vëndet që e ruajnë të freskët identitetin historik, do të përshkohet një itinerar mjaft interesant:

Gjatësia e rrugës asfalt “Enkelana”, 10 Km.

Nisja , Starti qendra e qytetit Pogradec.


Vijon drejt fshatit turistik të Drilonit.

Mbërritja, finish në qendër të qytetit të Pogradecit.





SKEMA E ZHVILLIMIT E MARATONËS 10 KM



11. Përcaktimi i pjesëmarrësve dhe ndihmësve (vullnetarëve).

Rëndësi të madhe në mbarëvajtjen e aktivitetit kanë vullnetarët ata luajnë rol si ndihmues dhe nuk janë vrapues në maratonë, janë të parastacionuar dhe të përgaditur për pritjen e vrapuesve në vënd furnizimin me ujë, lëngje, fruta, etj,

Puna e tyre fillon dy ditë perpara me shpërndarjen e materialeve ndimëse, ata janë lehtësisht të identifikueshëm me mbishkrimin “STAF” gjatë zhvillimit të maratonës mushama, shënja dalluese, kapele, fletë palosje, etj.

Këta individe kanë cilësi të mira për të ndimuar dhe shërbyer për furnizim me ujë, lëngje freskuese, kola, fruta të shpejta dhe kryesisht fruta të stinës, banane, limon, shalqi, qershia etj.

Kryesisht vullnetarët janë grupe të moshave të reja (nxënës shkolle) të organizuar me përgjegjës dhe mbajnë përgjegjësi për administrimin në tërësi të vënd qëndrimit dhe furnizimit në mënyrë që të mos e lënë asnjë pjesëmarës pa shërbimin e duhur, japin edhe support për kërkesa të ndryshe që ata mund të kenë...

Vullnetarët duhet të jenë njohës të mirë të skemës së hartës së zhvillimit të garës dhe ta kenë bërë rikonicionin një ditë më parë dhe të njihen hollësisht me materialet që do të shërbejnë, atyre u ipen porosi shumë të sakta sepse kane një rol kryesor në mbarëvajtjen e aktivitetit.

Grupet e vullnetarëve kordinojnë shoqërojnë maratonistët dhe u japin atyre asistencën e duhur, duke filluar nga stacioni i parë në drejtim të stacioneve të fundit por gjithnjë duke u siguruar që nuk presin më njeri në stacionin e tyre por minimumi lënë aq persona dhe materiale që ti shërbejnë edhe maratonistit të fundit. Kjo është e rëndësishme sepse është pjese e kontratës së një pjesëmarësi me organizatorin e aktivitetit. Përgjithësisht vullnetarëve u ipen shpërblime për ditën që ato angazhohen, dhurata etj.

12. Zbatimi i Projektit

a. Kush e zbaton këtë projekt.

Projekti do të zbatohet nga shoqata e “Maraton Albania” në bashkëpunim me disa anëtarë të cilët kanë qënë të përfshirë në fazat përgaditore dhe që kanë eksperiencë të ngjashme.

Disa anëtarë të shoqatës “Maraton Albania” me eksperiencë zgjidhen edhe përgjegjës të disa shërbimeve kryesore të përgaditjes dhe zhvillimit të maratonës , sikurse;

- ✓ Përgjegjës për skuadrat e stacioneve të furnizimit me ujë dhe lëngje freskuese,
- ✓ Përgjegjës për skuadrën e shoqërimit të maratonistave dhe organizimin e startit,
- ✓ Përgjegjës për grupin e organizimit të finishit dhe ceremoninë e laurimeve
- ✓ Përgjegjës për grupin e mbarëvajtjes së garës, sigurinë rrugore, etj.
- ✓ Përgjegjës për grupin e logjistikës, akomodimin, transportin e materialeve etj.

b. Përcaktoen skuadrat dhe organizimin me persona që njohin njëri tjetrin brenda skuadrave dhe ti jepen detyra konkrete, për mënyrën e realizimit me shpejtësinë e duhur.

Zakonisht për grupet në stacionet e pushimit, furnizimit me ujë dhe me lëngje do të bashkohen me grupet pas ardhëse dhe rifillojnë mbështesin përsëri me të njëjtën natyrë shërbimi grupet e tjera drejt finishit. Kjo për arsye sigurie dhe mungese personeli, lodhje të vrapuesve të cilët kërkojnë më shumë shërbim dhe lëngje freskuese, fruta në stacionet pas ardhëse drejt finishit në mënyrë që të sigurojmë vazhdimësinë intensive që ndodh nëpër garat e maratonës, dhe në finish përforcohen shpërndarësit e medaljeve dhe të shërbimit me ujë, lëngje freskuese, fruta të stinës.

c. Grupi drejtimit teknik, juridik, mjekësor dhe i logjistikës.

Këto tre grupe kanë një rëndësi të veçantë në mbarëvajtjen e maratonës dhe janë një pjesë e rendësishme me detyra konkrete të paracaktuara dhe mirë përgaditura.

- Grupi drejtimit teknik përbëhet;
 - 1.Dashamir Çali Kryetar
 - 2.Stefanaq Godella Anëtar
 - 3.Genc Lugja Anëtar
- Grupi drejtimit juridik përbëhet;
 - 1.Eksena Qirici Kryetare
 - 2.Kreshnik Kolgjoni Anëtar
 - 3.Petro Tusha Anëtar
- Grupi drejtimit Mjeksor përbëhet;
 - 1.Neritan Kurteshi Kryetar
 - 2.Shkelqim Roci Anëtar
 - 3.Haki Bejko Anëtar
- Grupi drejtimit logjistikes përbëhet;

1. Leonard Peço Kryetar
2. Albana Bruci Anëtare
3. Lorenc Vogli Anëtar

d. Mbledhje paraprake me anëtarët e shoqatës për menyrën e veprimit dhe të organizimit.

Në ditët në vijim, të djelave në stërvitjen e rradhës që do të bëhet, do të organizohet një mbledhje e zgjeruar dhe e detajuar me të gjithë anëtarët e shoqatës, kjo mbledhje do të konsistojë në informimin për aktivitetin e gjysëm maratonës së natës në qytetin e Pogradecit **“Enkelana”**.

Do të punohet projekti me detaje, mënyra organizimit, shpërndarja dhe caktimi i detyrave tek anëtarët e shoqatës sipas grupeve.

Do të informohen anëtarët dhe t’u bëhet e qartë që regjistrimi është i detyrueshëm për anëtarët e shoqatës ndërsa për pjesëmarrësit e tjerë është kosto plus shpenzimet administrative të shoqatës.

Në vijim do të jetë edhe një koktej

e. Përcaktoen emrat që drejtojnë skuadrat, grupet, caktohen detyrat.

1. Skuadra e parë, udhëzohet dhe drejtohet nga Dashamiri dhe Adriani.
2. Skuadra e dytë, udhëzohet dhe drejtohet nga Lorenc Vogli, Marjol Lamçe.
3. Skuadra e tretë, udhëzohet dhe drejtohet nga Albana Bruci, Petro Tusha.
4. Skuadra e katërt, udhëzohet dhe drejtohet nga Neritani Kurteshi, Haki Bejko.
5. Skuadra e pestë, udhëzohet dhe drejtohet nga Eksena Qirici, Petro Tusha,
6. Skuadra e gjashtë, udhëzohet dhe drejtohet nga Stefanaq Godella, Bashkim Luca.

f. Përcakto njeriun që do kryejë pagesat.

1. Me pagesat do të meret Leonard Peço

13. Kontrolli dhe monitorimi.

▪ **Raportimet nga pjesëmarrësit,**

Në çdo vend qëndrimi apo pushimi duhet që anëtarët raportojnë tek personat e drejtimit të skuadrës për mungesën apo problemet e hasura gjatë rrugës.

▪ **Mbaj disa takime deri në realizimin e maratonës,**

Duhet që të vazhdojë kontakti me anëtarët e shoqatës me telefon, takime, stërvitje etj. Sidomos me planin që kanë bërë përgjegjësit e grupeve të punës masat që kanë marrë dëgjohen syzjerimet e tyre.

▪ **Menaxhimi dhe vlerësimi i performancës së secilit person, skuadër apo grup.**

Duhet të motivuar performanca e punës për secilin drejtues grupi dhe skuadre.

▪ **Menaxhimi i buxhetit dhe transparenca.**

Personat që menaxhojnë buxhetin duhet ta bëjnë sa më transparent atë për të qënë të saktë me të gjithë ata që meren me përgaditjen , organizimin dhe mbarëvajtjen e maratonës.

▪ **Diskutohet plani kalendari i zhvillimit të detyrave të monitorimit.**

Në takimin e radhës të shoqatës diskutohet dhe miratohet plani i punës për realizimin e detyrave për organizimin dhe mbarëvajtjen e maratonës së natës në qytetin e Pogradecit.

▪ **Logo e aktivitetit.**

Dizenjimi i logos së aktivitetit ka rëndësinë e saj sepse është shoqëruese dhe shpjeguese e të gjithë materialeve të maratonës, dekorit, bluzat e vrapimit, chip të vrapimit.

Logo e aktivitetit mbetet e përherëshme me regjistrimin e maratonës në word maratho.

▪ **Përgaditja Logjistike.**

Në varësi të kapaciteteve dhe pritshmërive fillon edhe përgaditja e kontraktorëve për çantat, bluzat , medaljet , furnizimet me ujë, lengje freskuese, fruta etj.

Përpara dhe në vijim të zhvillimit të aktivitetit Kryetari z. Dashmir Çali dhe Sekretari i shoqatës bëjnë transparencën e fondeve nga;

- a. Shërbime apo blerje të mbuluara nga donatorët dhe kush nga donatorët.
- b. Blerje apo shërbime, shpenzime të kryera nga anëtarët e saj për qëllime të aktivitetit të projektit.
- c. Raportimi periodik për gjëndjen e arkës apo detyrime ndaj shtetit.

14. Regulla të detyrueshme për çdo pjesëmarrës;

Për një mbarëvajtje sa më të mirë të maratonës Shoqata e “Maraton Albania”, synon të sigurojë të gjithë elementët teknik, juridikë dhe mjekësor.

Në half maratonën e 21 Km, marin pjesë të gjithë ata që kanë mbushur moshën 18 vjeç , ndërsa në maratonën 10 km mund të marin pjesë të gjithë ata që kanë mbushur moshën 16 vjeç.

Në drejtimin mjeksor, jemi fokusuar në nevojat psikologjike që kanë anëtarët pjesëmarrës në maratonë, këshillimin dhe orientimin e kontrolleve të nevojshme mjeksore përpara maratonës, këshillimin mbi dietën ushqimore dhe nevojat specifike që kanë anëtarët dhe konkretisht nga të gjithë duhet të paraqitet;

a. Raport shëndetësor nga mjeku i familjes që nuk ka problem me shëndetin dhe është në gjëndje të mirë shëndetësore pjesëmarrësi.

Grumbullimin dhe kontrollin e raporteve shëndetësore dhe kontrollin e tyre bëhen nga mjeku i shoqatës, z. Neritan Kurteshi.

b. Plotësimi i formularit të pjesëmarrjes ku ndër të tjera çdo pjesëmarrës është i ndërgjegjshëm për eventin ku do të mari pjesë dhe mer përsipër vetë edhe pasojat që vijnë nga lodhja, rruga e gjatë, kushtet e motit, temperaturat apo rreshjet e shiut dhe gjithshka që ka të bëjë me vrapimin apo ecjen në natyrë.

Formularin e përgatit dhe i grumbullon, mjeku shoqatës, z. Neritan Kurteshi dhe zj. Eksena Qirici. juriste e shoqatës

15. Përcaktimi shpërblimeve, dhuratave, çertifikatave etj. për fituesit.

Në mbledhjen e përbashkët donator dhe organizator dhe në varësi të pritshmërive bëhet edhe përcaktimi i shpërblimeve, dhuratave, çertifikatave me një bazë sa më të gjërë në varësi të fondit në dispozicion i vendosur nga donatorët,

- Çmime për vëndet e para vajza dhe djem.
- Grup moshat 35- 45, 45 – 55, 55 – 65, vjeç dhe mbi 60 vjeç, vajza e djem.
- Pjesëtari më i ri dhe më i madh në moshë.
- Për organizatorët e maratonës dhe donatorët.

16. Sigurimi në kohe dhe kontraktimi i kompanisë matëse të kohës me Chip.

Pjesë e rëndësishme është kontraktimi në kohën e duhur i kompanisë që do të masë kohën dhe do të prodhojë numurat me Chip të personalizuar me emrin e çdo pjesëmarrësi.

Përcaktohen vëndet e matjes së kontrollit të kohës ndërmjetëse per 10 Km dhe half maratonën kjo detyrë duhet përfunduar me marjen e vendimit për zhvillimin e maratonës dhe duhet raportuar sa më parë.

17. Mbyllja e projektit

Vlerësim mbi realizimin e projektit, u arritën objektivat dhe qëllimet? Takim me gjithë ekipin pjesëmarrës dhe mbyllja konkluzionet.

Vlerësime nominale dhe në grup, ndoshta dhe një koktejl.

18. Vlerësim mbi realizimin e projektit,

U arritën objektivat dhe qëllimet e projektit,takim me gjithë ekipin pjesëmarrës dhe mbyllja e konkluzionet.

Vlerësime nominale, si skuadër, ndoshta dhe një koktail.

19. Partnerët dhe sponsorët.....

- Materiale sikurse ujë, lëngje freskuese, fruta.
- Mjete monetare.
- Pagesa për postera, dekore, media, podjume, finishe.
- Etiketat profesionale me chip, kohë matës etj. tabela afishimi elektronike etj.
- Përfshinë njëriëz, personel, vullnetarë.
- Ndërmjetësojnë me kompani dhe shërbime të tjera.
- Ata do të përfshihen në ceromoni.
- Do t'u bëhet promocion, logot e tyre do të shoqërojnë të gjitha materialet e maratonës.

20. Sponsor i zhenral i aktivitetit

Ky duhet menduar që të perfshihet në projekt me kontratë me noterizim në një përqindje të caktuar për ndarjen e të ardhurave që realizohet nga aktiviteti në një fazë të dytë kur kjo të kthehet në maratonë zyrtare

Sponsori ose sponsarat zheneral mbulojne 100 % të kosos dhe në përfundim kur grumbullohet tarifa e pjesëmarrjes, të ardhurat nga reklama, televizioni etj. ndahen në përqindje me shoqatën e cila luan rolin e organizatorit teknik dhe profesional.

Kryesia shoqatës “Maraton Albania”, duhet mendojë mirë.., sepse ky është rasti që shoqata mund të nxjeri ndonjë të ardhur për të mbijetuar dhe të risi kapacitetet e saj....për uniforma, logime, materiale decorative, mjete transporti, logjistikë tej.

Në ligj theksohet që Bashkitë e Qyteteve, mbështesin projektet , duke i paraqitur ato, si një projekt kulturor, sportive. masive. gjithashtu projekti promovon më së miri edhe turizmin në këto treva.

Grupi i Punës

Faleminderit për vëmëndjen, shpresojmë se do të bëheni pjesë e këtij projekti.



KRYETARI
DASHAMIR ÇALI

SEKRETARI
LEONARD PEÇO

ALBANIA





